



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 4366 Prot.

Ballsh, më 21 . 12 . 2021

VENDIM

NR. 56 Datë 20 . 12 . 2021

PËR

**KATEGORIZIMIN E NIVELEVE TË PËRFAQËSIMIT TË NXËSËSVE NË
OLIMPIADAT RAJONALE, KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE, NË
MATURËN SHTETËRORE, ÇMIME TË TJERA DHE PËRCAKTIMI I MASËS SË
SHPËRBLIMIT TË TYRE**

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, neni 28, pika 4, gërma b, e ligjit “69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

VENDOSI

1. Nxënësit ekselent në arsimin publik në arsimin parauniversitar publik (i mesëm i lartë) në bazë të listës së paqazitur nga ana e Zyrës Vendore Arsimore Mallakastër (sipas kriterëve të përcaktuara) përfitojnë një masë shpërblimi prej 5000 (pesëmijë) lekësh në muaj për një periudhë 9 (nëntë) mujore (pagesa do të kryhet cdo 3 (tre) muaj).
2. Miratimin e niveleve të përfaqësimi të nxënësve në Olimpiadat Rajonale, Kombëtare dhe Ndërkombëtare, si dhe masën e shpërblimit të tyre, si më poshtë:

Nr.	Niveli i përfaqësimit	Rezultati	Shpërblimi në lekë
1	Olimpiada Botërore	a. Vendi I b. Vendi II c. Vendi III d. Honorable Mention (çmim inkurajues) e. Përfaqësimi	a. Deri në 400 000 b. Deri në 300 000 c. Deri në 200 000 d. Deri në 70 000 e. Deri në 50 000
2	Olimpiada Europiane	a. Vendi I b. Vendi II c. Vendi III d. Përfaqësimi	a. Deri në 200 000 b. Deri në 150 000 c. Deri në 100 000 d. Deri në 40 000
3	Olimpiada Ballkanike	a. Vendi I b. Vendi II c. Vendi III d. Përfaqësimin	a. Deri në 100 000 b. Deri në 80 000 c. Deri në 65 000 d. Deri në 30 000
4	Olimpiada Kombëtare	a. Vendi I b. Vendi II c. Vendi III	a. Deri në 40 000 b. Deri në 30 000 c. Deri në 20 000

5	Olimpiada Rajonale	a. Vendi I b. Vendi II c. Vendi III	a. Deri në 20 000 b. Deri në 15 000 c. Deri në 10 000
6	Matura Shtetërore	a. Më i Miri i Maturës Shtetërore b. Medalje e Artë	a. Deri në 70 000 b. Deri në 100 000

3. E drejta e shpërblimit parashkruhet pas 3 viteve nga data e lëshimit të certifikatës, i referohet vetëm rastit të pjesëmarrjes në olimpiadat Rajonale, Kombëtare dhe Ndërkombëtare.
4. Masat e shpërblimit të mësipërm i përfitojnë nxënësit që kanë vendbanimin dhe vendqendrimin në Bashkinë Mallakastër.
5. Fituesit e Olimpiadave Ndërkombëtare, në rastin e përfaqësimit duhet të paraqesin faturën e shpenzimeve dhe në cdo rast; 1. kërkesën për shpërblim, 2. certifikatën e olimpiadës të noterizuar, 3. vërtetimin për njohjen e kësaj olimpiade nga DRA ose MSA, 4. certifikatën familjare, 5. vërtetimin e vendbanimit / vendqendrimit.
6. Nxënësit ekselent në arsimin publik parauniversitar (i mesëm i lartë), në bazë të listës së paraqitur nga ana e Zyrës Vendore Arsimore Mallakastër (sipas kritereve ligjore) përfitojnë një masë shpërblimi prej 5000 (pesë mijë) lekësh /muaj për një periudhë 9 (nëntë) mujore (pagesa do të kryhet nga ana e Bashkisë Mallakastër) çdo tre muaj
7. Në rastet kur Olimpiada përcakton si çmime : Medalje e Artë, Medalje e Argjend, Medalje Bronzi, ato ekuivalentohen përkatësisht me : Vendi I, Vendi II, Vendi III referuar tabelës së mësipërme.
8. Ky vendim shoqërohet me relacion shpjegues.
9. Efektet financiare do të parashikohen në buxhetin e Bashkisë Mallakastër për vitin 2022.
10. Ngarkohet në zbatimin e këtij vendimi ekzekutivi i Bashkisë Mallakastër.
11. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.



KRYETAR

Mbarime Isufaj